

# Sanksionimi i të drejtave të të moshuarve Drejt një Konvente të Kombeve të Bashkuara

---



---

Një mjet për promovimin e një dialogu për  
krijimin e një Konvente të re të Kombeve të  
Bashkuara mbi të Drejtat e të Moshuarve

## Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Pse është i rëndësishëm moshimi demografik?.....	3
3. Vendosja e të drejtave të të moshuarve në kontekstin e duhur.....	4
4. Ligji ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut.....	6
5. Pse duhet një Konventë – çfarë do të bëjë ajo?.....	8
6. Pse nevojitet një Raportues Special – çfarë do të bëjë ai ose ajo?.....	10
7. Çfarë mund të bëni ju?.....	10
8. Bibliografia e Konventës së Kombeve të Bashkuara.....	12

## 1. Hyrje

Të moshuarit, qofshin burra apo gra, kanë të njëjtat të drejta si çdokush tjetër: të gjithë ne kemi lindur të barabartë dhe kjo s' duhet të ndryshojë kur plakemi. Edhe pse duhet të jetë kështu, në përgjithësi të drejtat e të moshuarve zënë shumë pak vend në kuadrin e legjislacionit ndërkombëtar.

Pavarësisht ekzistencës së Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, të moshuarit nuk pasqyrohen në mënyrë eksplicite në ligjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, të cilat detyrojnë ligjërisht qeveritë të zbatojnë të drejtat e të gjithë njerëzve. Vetëm një konventë ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut (Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë punonjësve migrant dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre) do të sanksiononte mungesën e diskriminimit moshor. Nga ana tjetër, ekzistojnë angazhime mbi të drejtat e të moshuarve, siç është Plani Ndërkombëtar i Veprimit në Madrid (MIPAA). Megjithatë, këto angazhime nuk janë ligjërisht të detyrueshëm dhe për këtë arsye ato vetëm ushtrojnë një detyrim moral mbi qeveritë për t'i implementuar.

Zhvillimi i një konvente e re mbi të drejtat e të moshuarve është e domosdoshme, në mënyrë që sigurohet zbatimi i të drejtave të të moshuarve. Me një konventë të re të Kombeve të Bashkuara (KB), si dhe me asistencën e një Raportuesi Special, qeveritë mund të kenë një kuadër të qartë ligjor, drejtim dhe mbështetje, çka do t'i mundësojë atyre zbatimin e të drejtave të të moshuarve në një shoqëri që po shkon drejt plakjes.

Ndryshimi demografik do të çojë në një numër të paprecedentë të të moshuarve në mbarë botën dhe ata do të dëmtohen direkt nga diskriminimi i moshës dhe moshizmi. Prandaj është e rëndësishme rritja e presionit mbi qeveritë dhe shoqërinë si një e tërë për t'u përgjigjur. Forcimi i të drejtave të të moshuarve është përgjigja e vetme më e mirë. Edhe pse zhvillimi i një konvente të Kombeve të Bashkuara miratohet nga qeveritë, suporti nuk mund të arrihet pa përkrahjen dhe advokacinë e të moshuarve. Një rol kyç që kjo të ndodhë, luajnë organizatat e shoqërisë civile, të cilat gjithashtu mund ti kërkojnë llogari qeverive për vendimet e ndërmarra. Kjo është arsyeja që shoqëria ka nevojë për përfshirjen aktive të të moshuarve.

Ky botim u prodhua për të përforcuar kuptimin dhe njohuritë mbi nevojën për një konventë mbi të drejtat e të moshuarve. Ai synon të sigurojë argumentet dhe mjetet për të përfshirë aktorët në mbarë botën në debatin mbi të drejtat e të moshuarve dhe rolit që do të ketë konventa. Ne inkurajojmë të gjithë ata që mund ta përkthejnë këtë publikim në sa më shumë gjuhë të huaja.

## 2. Pse është i rëndësishëm moshimi demografik?

Moshimi i popullsisë është një nga triumfet më të mëdha njerëzore. Ai është gjithashtu një nga sfidat tona më të mëdha dhe përcakton kërkesat lidhur me rritjen ekonomike dhe sociale në të gjithë vendet. Në mbarë botën, proporcioni i njerëzve  $\geq 60$  vjeç është duke u rritur dhe do të vazhdojë të rritet më shpejt se grup - moshat e tjera, për shkak të rënies së fertilitetit dhe rritjes së jetëgjatësisë.

Numri i të moshuarve mbi 60 vjeç pritet të rritet nga 600 milion që ishin në vitin 2000, në mbi 2 miliard në 2050-ën. Kjo rritje do të jetë më e madhe dhe më e shpejtë në vendet në zhvillim, në të cilat numri i të moshuarve pritet të trefishohet gjatë 40 viteve të ardhshme. Në 2050, mbi 80% e të moshuarve në mbarë botën do të jetojnë në vendet në zhvillim. Në të njëjtën kohë, numri i më të moshuarve (ata mbi 80 vjeç), në botën e zhvilluar do të arrijë nivele të paparashikuara<sup>1</sup>.

Gjatë moshimit, të moshuarit kanë nevojë për mbështetje të mjaftueshme financiare, për shanse punësimi modest, në mënyrë që të mbeten aktivë, si dhe për akses dhe shërbime të përshtatshme shëndetësore dhe sociale, duke përfshirë edhe kujdesin afatgjatë. Gjithashtu, numri më i lartë i grave që jetojnë shumë gjatë, përbën një sfidë madhore për politikbërësit.

Mungesa e politikave, që të adresojnë këto probleme, ndërshkon miliona të moshuar drejt një jetese të varfër, si dhe çon në mosnjohje të kontributeve ekonomike dhe sociale që të moshuarit i kanë bërë familjeve të tyre, komuniteteve dhe shoqërisë si një e tërë.

### 3. Vendosja e të drejtave të të moshuarve në kontekstin e duhur

#### Çfarë janë të drejtat e njeriut?

Të drejtat e njeriut janë të drejtat që i atribuohen njerëzve thjesht për faktin se ato janë qenie njerëzore, pavarësisht

moshës, nënshtetësisë, kombësisë, racës, etnicitetit, gjuhës, gjinisë, seksualitetit ose aftësive. Kur këto të drejta të qenësishme respektohen, njerëzit mund të jetojnë me dinjitet dhe barazi, të lirë nga diskriminimi.

Të drejtat e njeriut janë universale, të pranuarra gjerësisht dhe kryesore në kuptimin tonë mbi njerëzimin. Koncepti i të drejtave njerëzore është zhvilluar përgjatë kohës dhe e ka origjinën në një sërë traditash filozofike, morale, religjioze dhe politike. Nuk ka një hartëzim historik lidhur me evoluimin e të drejtave në kuptimin që ne kemi për to sot. Kjo është ajo që i jep të drejtave kuptimin universal të tyre.

#### Cilat janë të drejtat e të moshuarve?

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut deklaron në artikullin I se “*të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta për sa i përket dinjitetit dhe të drejtave*”. Kjo barazi nuk ndryshon me kalimin e moshës: të moshuarit, burra ose gra, kanë të njëjtat të drejta sikurse personat më të rinj se ata.

Të drejtat e të moshuarve nuk janë përfshirë ende specifikisht në konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mbi aspekte të tilla si të drejtat ekonomike, sociale, qytetare, kulturore dhe politike. Shembujt përfshijnë të drejtën për mbrojtje të barabartë përpara ligjit, të drejtën mbi pronën, të drejtën për arsimim, të drejtën për të punuar dhe të drejtën për të marrë pjesë në qeveri.

Disa të drejta mund të kenë më shumë lidhje me pleqërinë, krahasuar me periudhat e tjera të jetës, p.sh. e drejta për

<sup>1</sup> Burimi: Seksioni për Popullsinë në Departamentin e Ekonomisë dhe Cështjeve Sociale të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, *Projeksione të Popullsisë Botërore: Rishikim 2008* : <http://esa.un.org/unpp>

sigurime shoqërore në formën e një pensioni. Disa herë një e drejtë që mund të ketë qenë respektuar kur dikush ishte i ri mund të mos jetë po aq protektive në moshë të thyer, psh. e drejta për akses të përshtatshëm ndaj shërbimeve shëndetësore dhe sociale.

### **Pse është e rëndësishme promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të të moshuarve?**

Të drejtat e njeriut i ndryshojnë jetën për mirë popullatës. Mbrojtja e të drejtave të të moshuarve do të shërbejë për t'i mundësuar atyre një jetë dinjitoze dhe të sigurt, si anëtarë të barabartë të shoqërisë.

Diskriminimi ndaj çdo grupi të shoqërisë është i papranueshëm. Me plakjen e shpejtë të popullsisë, përshkallëzohet edhe prevalenca e diskriminimit moshor, duke e bërë kështu të domosdoshme adresimin e çështjeve themelore të diskriminimit. Trajtimi me respekt i të moshuarve dhe në kushte të njëjta me të rinjtë mundëson të gjithë individët që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e tyre personal. Është e rëndësishme të kujtohet që të rinjtë e sotëm do të jenë të moshuarit e së nesërmes.

### **Cila është lidhja midis moshizmit, diskriminimit moshor dhe të drejtave të të moshuarve?**

Moshizmi nënkupton një konotacion stereotipik paragjykimesh diskriminuese lidhur me moshën e individit. Diskriminimi moshor ndodh kur dikush trajtohet ndryshe për shkak të moshës së tij. Moshizmi dhe diskriminimi moshor mund të rezultojë në dhunim të të drejtave të të moshuarve. Ata vazhdojnë të

tolerohen në të gjitha nivelet e shoqërisë: nga individët dhe institucionet; përmes politikave lokale apo kombëtare; sikurse në sektorin e biznesit.

Është e rëndësishme të kujtojmë që të moshuarit nuk janë një grup homogjen. Burrat dhe gratë plaken në mënyra të ndryshme dhe diskriminimi që ata përjetojnë shpesh është multidimensional, bazuar jo vetëm në moshë, por edhe në faktorë të tjerë, si gjinia, origjina etnike, vendi ku banojnë, aftësitë e kufizuara, varfëria, seksualiteti ose niveli i shkollimit.

### **Si dhunohen të drejtat e të moshuarve?**

Të drejtat e të moshuarve dhunohen në mënyra të ndryshme, ku përfshihen:

- **E drejta e të moshuarve për të qenë të lirë nga diskriminimi**

Të moshuarve, burra dhe gra, shpesh i mohohet aksesin ndaj shërbimeve, punëve ose trajtimit pa respekt për shkak të moshës së tyre dhe faktorëve të tjerë si gjinia ose aftësitë e kufizuara.

- **E drejta e të moshuarve për të qenë të lirë nga dhuna**

Të moshuarit, burra dhe gra, shpesh janë subjekt i abuzimit, si ai verbal, seksual, psikologjik dhe financiar.

- **E drejta e të moshuarve për siguri sociale**

Shumë të moshuar nuk kanë mbrojtje financiare, siç janë pensionet apo forma të tjera të sigurimeve shoqërore. Mungesa e sigurimit të një minimumi të ardhurash mund t'i çojë të moshuarit dhe familjet e tyre në varfëri.

- **E drejta e të moshuarve për shëndet**

Të moshuarit, për shkak të moshës, mund të mos marrin kujdesin e duhur shëndetësor dhe social. Atyre mund t'u mohohet trajtimi ose mund të marrin shërbime të pamjaftueshme.

- **E drejta e të moshuarve për të punuar**

Shpeshherë të moshuarit konsiderohen si “jo të aftë për t'u punësuar” për shkak të moshës së tyre – ky është dhunim i të drejtave të njeriut, pasi çdokush ka të drejtë që të punësohet përsa kohë që e konsideron veten të aftë për punë. Për më tepër, të moshuarit mund të detyrohen të ndërpresin punën për shkak të arritjes së moshës së pensionit.

- **E drejta e të moshuarve për të patur pronë dhe për ta trashëguar atë**

Në shumë pjesë të botës, ligjet mbi trashëgiminë, mohojnë të drejtën e grave të çdo lloj moshe të zotërojnë ose trashëgojnë pronën kur bashkëshorti i tyre vdes. Anëtarët e familjes shpesh detyrojnë me forcë vejtashat të heqin dorë, ose ia konfiskojnë pronën, duke përbërë kështu një dhunim të të drejtave të tyre mbi pronësinë e barabartë, menaxhimin dhe shitjen e pasurisë.

## **4. Ligji ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut**

### **Çfarë është ligji për të drejtat e njeriut?**

Ligji për të drejtat e njeriut siguron një sistem i cili kodifikon të drejtat e njeriut dhe i bën ato të detyrueshme për tu zbatuar. Ai lidhet kryesisht me marrëdhënien midis shtetit dhe individit.

Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut është i përbërë nga një numër traktatesh, që zakonisht quhen konventa ose marrëveshje. Këto njihen si ligjet “e rrepta”, sepse kur një vend anëtar i BE-së ratifikon një traktat, ky bëhet ligjërish i detyrueshëm për këtë vend. Kjo do të thotë që vendet anëtare duhet të rishikojnë ligjet e tyre në të njëjtën linjë me traktatin dhe të njohin politikën dhe programet për të zbatuar pjesë të ndryshme të traktatit. Traktati quhet i dhunuar, nëse vendi anëtar dështon në përshtatjen e ligjeve në të njëjtën linjë me të.

Çdo traktat ka një sistem monitorimi, zakonisht në formën e një komiteti me ekspertë të pavarur. Shtetet që kanë ratifikuar një traktat raportojnë rregullisht tek ky komitet mbi progresin e tij në zbatimin e dispozitave. Komiteti ekzaminon këto raporte dhe bën rekomandimet se si vendi anëtar mund të zbatoj më mirë traktatin. Gjithashtu, shumica e komiteteve mund të ekzaminojnë dhe investigojnë ankesat individuale mbi dhunimin e të drejtave.

Nga ana tjetër ka edhe një pjesë të ligjit që merret me trajtimin e të moshuarve, ku bëjnë pjesë Parimet e Kombeve të Bashkuara për të Moshuarit (1991) dhe Plani Ndërkombëtar i Veprimit të Madritit (MIPAA 2002). Megjithëse të drejtat e njeriut përforcojnë rekomandimet e këtyre ligjeve “të buta”, ato nuk janë ligjërish të detyrueshme. Shtetet janë më shumë nën një obligim moral se sa ligjor për të ndjekur këto rekomandime. Raporti i vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara në MIPAA në vitin 2007, tregoi angazhime të parregullta të qeverive për zbatimin dhe rishikimin e tyre, sikurse një

përfshirje të parregullt të të moshuarve në këtë proces<sup>2</sup>.

### **A është e mjaftueshme mbrojtja nëpërmjet ligjit ekzistues ndërkombëtar dhe rajonal?**

Të drejtat e të moshuarve mbrohen në një kuptim të përgjithshëm nëpërmjet ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut aplikohet për njerëzit e të gjitha moshave. Si Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR 1996), ashtu edhe Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR 1996) aplikohen tek çdo person pavarësisht moshës së tyre.

Megjithatë, kjo mbrojtje nuk është e mjaftueshme. Pavarësisht nga ndonjë përjashtim (mbi punëtorët emigrantë dhe familjet e tyre), konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut nuk shprehin specifikisht se diskriminimi moshor nuk duhet lejuar. Gjithashtu edhe ligjet rajonale mbi të drejtat nuk mbrojnë në mënyrë sistematike ose të hollësishme të drejtat e të moshuarve.

Kjo mungesë e dispozitës ligjore mbi të drejtat e njeriut njihet si një “hendek normativ”. Në ligjin ekzistues të të drejtave të njeriut, ka një numër të hendekëve normativ të cilat nuk janë adresuar në ligjin ekzistues mbi të drejtat e njerit, aspekte të jetës së të moshuarve, si p.sh: standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e komunitetit, që lidhen me elementë të kujdesit afat-gjatë si për atë që

ushtron kujdesin, ashtu edhe për atë që e merr atë; planifikime ligjore për të moshuarit; si dhe heqja e moshës së detyrueshme për pension. Gjithashtu, një vëmendje urgjente kërkon barazia dhe kapaciteti ligjor para ligjit për gratë dhe burrat e moshuar që janë nën kujdestari.

Veç kësaj, standardet që mbrojnë të drejtat e të moshuarve janë vendosur në marrëveshje të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale. Parashtrimi i këtyre dispozitave së bashku në një tekst të vetëm, sikurse është bërë në mënyrë të suksesshme për të drejtat e grave, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, do të paraqiste në mënyrë të qartë si natyrën e të drejtave të të moshuarve, ashtu edhe përgjegjësitë e nevojshme për ti mbrojtur ata.

### **A i ka mbrojtur ligji ekzistues ndërkombëtar të drejtat e të moshuarve?**

Praktikisht, të drejtat e burrave dhe grave të moshuar, nuk janë adresuar në mënyrë të përshtatshme, ose nuk janë mbrojtur nëpërmjet sistemit të të drejtave të njeriut. Kjo është njohur si një “hendek implementimi”. Grupet që bëjnë monitorimin e angazhimeve mbi të drejtat e njeriut rrallë herë pyesin për të drejtat e të moshuarve. Nga ana tjetër, edhe vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara, rrallë herë përfshijnë të moshuarit në raportet që i paraqitin grupeve të monitorimit. Gjithashtu, të moshuarit reflektohen shumë pak në sistemin e Rishikimit Periodik Universal, ku çdo vend anëtar i KB i raporton Këshillit të të Drejtave të Njeriut të dhënat mbi të drejtat e njeriut në vendin e tij.

<sup>2</sup> HelpAge International, *Out of the Shadows*, HelpAge International, February 2008

Ekzistenca e vazhdueshme e diskriminimit moshor dhe moshizmit në ligjet, politikat dhe praktikat kombëtare, është një shenjë që tregon se qeveritë kanë dështuar në inkorporimin adekuat të të drejtave të të moshuarve në ligjet, buxhetet dhe programet e tyre.

### **Çfarë mbështetje politike ekziston për të drejtat e të moshuarve?**

Në nivel rajonal, mbështetja politike mbi mekanizmat e rinj të të drejtave të njeriut është duke u rritur. Shtetet e Amerikës Latine janë duke punuar aktivisht për zhvillimin e një konvente rajonale mbi të drejtat e të moshuarve. Komisioni Afrikan po përgatit një protokoll të ri mbi të drejtat e të moshuarve në Kartën Afrikane mbi të drejtat e njeriut. Krijimi i një grupi të ri mbi të drejtat e njeriut sipas Kartës së Shoqatës së Kombeve Aziatike Jug-lindore (ASEAN) mund të sigurojë një mundësi për ti marrë në konsideratë të drejtat e të moshuarve në Azinë Jug-lindore.

Gjithashtu, brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara, ka një debat në rritje mbi të drejtat e të moshuarve. Komiteti që monitoron zbatimin e CEDAW –së (Konventa mbi Eliminim e të gjitha llojeve të Diskriminimit Kundra Grave) ka krijuar një grup pune për hartimin e një rekomandimi të ri të përgjithshëm mbi të drejtat e grave të moshuara. Ky grup do të sigurojë një “guidë” raportimi të vendeve anëtare për mënyrën se ata mund të mbrojnë më mirë të drejtat e grave të moshuara dhe do të inkurajojë raportime më sistematike. Komiteti Konsultativ në Këshillin e të Drejtave të Njeriut i ka vendosur të drejtat e të moshuarve si një çështje prioritare dhe në vitin 2010 do të prezantojë rekomandimet praktike se si

mund ta mbrojnë më mirë këtë gruposhë. Sekretari i Përgjithshëm po përgatit raportin mbi të drejtat e të moshuarve për ta paraqitur në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 2010.

## **5. Pse duhet një Konventë – çfarë do të bëjë ajo?**

### **Pse kemi nevojë për një konventë mbi të drejtat e të moshuarve?**

Ne kemi nevojë për një konventë të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e të moshuarve, sepse:

### **Moshizmi dhe diskriminimi moshor janë të papranueshme**

Meqë bota po shkon drejt një plakje të shpejtë, presioni që rezulton mbi diskriminimin moshor ka gjasa që të intensifikohet; kjo e bën të detyrueshme adresimin e një diskriminimi të tillë.

### **Të drejtat e njeriut ndryshojnë jetën e shoqërisë**

Mbrojtja e të drejtave të njeriut i ndihmon të moshuarit të jetojnë me dinjitet dhe të sigurojnë jetën, si anëtarë të barabartë të shoqërisë. Ushtrimi i këtyre të drejtave i mundëson atyre trajtimin me respekt dhe në kushte të barabarta me të rinjtë.

### **Ligjet ekzistuese ndërkombëtare dhe rajonale mbi të drejtat e njeriut nuk mbrojnë në mënyrë të mjaftueshme të drejtat e të moshuarve**

Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut dhe konventat ndërkombëtare mbi të drejtat aplikohen për të gjithë personat, pavarësisht moshës së tyre. Megjithatë,



mosha nuk është listuar qartë si një arsye për të cilën nuk duhet të ketë diskriminim. Ka një numër konventash rajonale të cilat mbrojnë të drejtat e të moshuarve, por jo në mënyrë sistematike dhe të hollësishme.

### **Të drejtat e njeriut dhe zhvillimi i shoqërisë ecin në paralel me njëra-tjetrën**

Respektimi i të drejtave të të moshuarve çon në një zhvillim më të mirë, ku respekti, dinjiteti dhe mendimi i lirë, së bashku me sigurinë materiale janë pranuar si elementë të rëndësishëm të mirëqenies së njerëzve.

Duke kërkuar gjithnjë e më shumë mbrojtjen e të drejtave të të moshuarve, krijohen kushte, të cilat i mundësojnë atyre të marrin pjesë dhe të kontribuojnë jo vetëm në zhvillimin e tyre personal, por edhe të gjërave përreth. Në këtë mënyrë, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të të gjithë njerëzve do të çojë në shoqëri më gjithëpërfshirëse, të paanshme dhe mbështetëse.

### **Të drejtat e njeriut sigurojnë standarde për ofrimin e shërbimeve**

Sektorët privat dhe vullnetar po pranojnë gjithnjë e më shumë impaktin që ata kanë tek njerëzit për të kuptuar të drejtat e tyre njerëzore. Shumë shërbime shëndetësore dhe financiare sigurohen nga biznesi dhe OJQ-të. Megjithëse konventa do të jetë ligjërisht e detyrueshme për shtetet që do ta ratifikojnë, sektorët privat dhe vullnetarë kanë nevojë për standarde për të siguruar shërbimet që respektojnë të drejtat e të moshuarve.

### **Çfarë duhet të bëjë një konventë?**

#### **Të luftojë diskriminimin ndaj moshizmit dhe moshës**

Një konventë duhet:

- ✓ Të ndihmojë në reduktimin e moshizmit dhe diskriminimit ndaj moshës;
- ✓ Të detyrojë shtetet ratifikuese të adaptojnë ligje jo-diskriminuese;
- ✓ Të tërheqë vëmendjen ndaj diskriminimit të shumëfishtë që përjetojnë të moshuarit;
- ✓ Të sigurojë bazat për advokaci, edukimi dhe përmirësimin e njohurive mbi të drejtat e të moshuarve;
- ✓ Të përforcojë përgjigjen e shoqërisë ndaj sfidave mbi ndryshimet demografike dhe të përmirësojë solidaritetin ndërbreznor.

#### **Të ndryshojë jetën e njerëzve**

Një konventë duhet:

- ✓ Të ndihmojë të moshuarit të jetojnë me dinjitet;
- ✓ Të ndryshojë mendimin që ekziston shpesh për të moshuarit, nga persona që “marrin lëmshë”, në individë me njohuri, pushtet dhe eksperiencë. Rritja e respektit për të moshuarit do të përmirësojë marrëdhëniet midis brezave të ndryshëm dhe do ta bëjë shoqërinë më të bashkuar.

#### **Të qartësoj përgjegjësitë**

Një konventë duhet:

- ✓ Të sigurojë mbrojtjen ligjore dhe të nevojshme për të drejtat e të moshuarve sipas ligjeve ndërkombëtare;
- ✓ Të shpjegojë se çfarë janë të drejtat e të

moshuarve si dhe standardet dhe veprimet minimale të nevojshme për t'i mbrojtur ata;

- ✓ Të bëjë të dukshme përgjegjësitë e shteteve dhe aktorëve të tjerë ndaj të moshuarve;
- ✓ Të plotësojë dhe të rrisë profilin e MIPAA-së dhe të Parimeve të Kombeve të Bashkuara për të Moshuarit;
- ✓ Të forcojë zbatimin e ligjit ndërkombëtar ekzistues nëpërmjet qartësisimit më të mirë të të drejtave të të moshuarve.

### **Të përmirësojë përgjegjëshmërinë**

Një konventë duhet:

- ✓ Të sigurojë një mekanizëm raportimi dhe përgjegjësie për veprimet e shteteve ndaj të moshuarve;
- ✓ Të sigurojë një sistem rregullator për dhunimin e të drejtave të të moshuarve;
- ✓ Të inkurajojë vazhdimin e dialogut midis shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, organizatave të shoqërisë civile, OJQ-ve, sektorit privat dhe vetë të moshuarve nëpërmjet monitorimit të zbatimit të tij.

### **Të drejtojë politik-bërjen**

Një konventë duhet:

- ✓ Të sigurojë një kuadër të qartë për të drejtuar vendimmarrjen politike;
- ✓ Të inkurajojë mbledhjen e të dhënave të lidhura me moshën dhe të informojë politikë-bërësit;
- ✓ Të promovojë programe sensitive ndaj moshës;
- ✓ Të ndihmojë qeveritë në alokimin e burimeve në mënyrën më të drejtë;
- ✓ Të inkurajojë zhvillime më të mëdha të programeve nga të cilat përfitojnë të moshuarit;

- ✓ Të drejtojë trajnimin e personelit shëndetësor, punëdhënësve, gjyqësorit dhe të tjerë të përfshirë në çështjet e të moshuarve;
- ✓ Të orientojë sektorin privat për mënyrën se si ai mund të mbrojë të drejtat e të moshuarve;

## **6. Pse nevojitet një Raportues Special – çfarë do të bëjë ai ose ajo?**

Një Raportues Special është një ekspert i caktuar nga Kombet e Bashkuara, i cili ekzaminon dhe raporton në Këshillin e të Drejtave të Njeriut çështje tematike ose gjeografike që lidhen me të drejtat njerëzore. Raportuesit Special ekzistues rrallë herë adresojnë në punën e tyre të drejtat e të moshuarve.

Një Raportues Special mbi të drejtat e të moshuarve mund të këshillojë dhe të mbështesë shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara për një zbatim më të mirë të MIPAA-së dhe eventualisht për një konventë të re. Ai/ajo mund të bëjë të dukshme të drejtat e të moshuarve nëpërmjet ekzaminimit dhe raportimit të natyrës dhe shtrirjes së dhunimit të të drejtave të tyre, si dhe duke bërë rekomandime se si mund të mbrohen më mirë të moshuarit. Gjithashtu, ai/ajo duhet të jetë në gjendje të inkurajojë raportuesit ekzistues që të adresojnë të drejtat e të moshuarve brenda fushës së tyre specifike të punës.

## **7. Çfarë mund të bëni ju?**

Një konventë e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e të Moshuarve nuk mund të arrihet pa mbështetjen e gjerë të publikut në shumë vende. Organizatat jo qeveritare

në çdo vend kanë rol esencial në këtë proces. Më poshtë janë disa sugjerime të përgjithshme lidhur me atë që mund të bëjnë OJQ-të për të promovuar një konventë në vendet e tyre.

**Filloni** me angazhimin i organizatës suaj në rolin e lidershit për të punuar në realizimin e një Konvente.

**Përktheni** dokumentet kyç të KB dhe dokumente të tjera, duke përfshirë edhe këtë publikim.

**Mblidhni** të dhëna mbi diskriminimin, abuzimin, neglizhencën ose dhunën ndaj të moshuarve për të mbështetur nevojën për një Konventë në vendin tuaj.

**Identifikoni dhe përdorni** burimet kombëtare dhe lokale, akademike dhe civile, veçanërisht për të dhënat e popullsisë dhe ato socio-ekonomike që i përkasin të moshuarve të vendit tuaj. Të dhënat mbi popullsinë mund ti gjeni në profilet demografike rajonale, në: <http://esa.un.org/unpp/index.asp>.

Të dhënat socio-ekonomike mundësohen në: [www.un.org/esa/population/unpop.htm](http://www.un.org/esa/population/unpop.htm)

**Zhvilloni dhe zbatoni** një strategji për të siguruar mbështetjen publike për një Konvent:

**Drejtojeni** grupeve të tjera (të rinjtë, grupet fetare, unione, gratë, personat me paaftësi) për të njohur ndërvarësinë sociale dhe për të edukuar solidaritetin social.

**Edukoni** anëtarët tuaj, OJQ-të e tjera, median, dhe të gjithë nivelet e qeverisë mbi nevojën për një Konventë.

**Gjeni dhe përdorni një slogan** të thjeshtë që të inkurajojë publikun për të mbështetur fushatën tuaj për një konventë.

**Formoni** koalicionet me grupe të tjera mbështetëse.

**Krijoni një network** për të ndarë informacionin midis organizatave dhe me publikun.

**Publikoni** një Konventë nëpërmjet Internet-it, YouTube, intervistave, gazetave dhe llojeve të tjera të medias.

**Identifikoni** arsyet pse oponentët janë kundër konventës dhe **përgatitni** kundërshtimin.

**Identifikoni** personat kyç që përgjigjen për të moshuarit në qeveri, si dhe aleatë të tjerë politikbërës lidhur me të drejtat e të moshuarve.

**Telefononi, shkruajini dhe takohuni** me ligjvënës dhe punonjës të administratës, në mënyrë që të advokoni për një Konventë.

**Shkëmbeni** informacion me organizatat e tjera brenda dhe jashtë vendit, lidhur me zhvillimet në vendin tuaj.

Source: Population Division of the Department of Economic and Social Affairs of the United Nations Secretariat, *World Population Prospects: the 2008 Revision*: <http://esa.un.org/unpp>

## 8. Bibliografia e Konventës së Kombeve të Bashkuara

Më poshtë janë listuar dokumentet më të rëndësishme për këdo që është i interesuar për zhvillimin e një Konvente të re të KB mbi të Drejtat e të Moshuarve.

**Të gjitha dokumentet e listuara këtu mund të gjenden në adresën e mëposhtme:**

[www.ageuk.org.uk/unconvention](http://www.ageuk.org.uk/unconvention)

**Të gjitha instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mund të gjenden në website-in e Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, në:**

[www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/InternationalLaw.aspx](http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/InternationalLaw.aspx)

### Dokumente zyrtare dhe në proces të KB

**Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut** është e vlefshme në më shumë 330 gjuhë dhe dialekte në:

[www.ohchr.org/EN/UDHR/Pages/Introduction.aspx](http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Pages/Introduction.aspx)

**Deklarata e Braziliës**, “Konferenca e Dytë Rajonale Ndërqeveritare për moshimin në Amerikën Latine dhe Karaibet; drejt një shoqërie për të gjitha moshat dhe të drejtat të bazuara në mbrojtjen sociale” ECLAC UN, Brasilia, Brazil, 4–6 Dhjetor 2007:

[www.eclac.org/celade/brasil2007](http://www.eclac.org/celade/brasil2007)

(varianti në anglisht është i i vlefshëm në website).

Konferencë Rajonale, e cila përfshin një angazhim për promovimin e draftit të konventës për të drejtat e të moshuarve brenda kornizës së KB.

**Takim i parë pasues i Deklaratës së Braziliës ECLAC**, Rio de Janeiro, Brazil, 16–17 Shtator 2008.

Raport përmbledhës nga Veprimtaria Globale për Moshimin për të vazhduar dhe përforcuar angazhimet e bëra në Brazilië, Dhjetor 2007.

**Takim i dytë pasues i Deklaratës së Braziliës ECLAC**, Buenos Aires, Argjentinë, 21–22 Maj 2009: [www.globalaging.org/agingwatch/events/regionals/eclac/rioreport2008.htm](http://www.globalaging.org/agingwatch/events/regionals/eclac/rioreport2008.htm)

Raport përmbledhës nga ECLAC i takimit të dytë vazhdues i angazhimeve të Deklaratës së Braziliës.

**Raport i Takimit të Grupit të Ekspertëve : ‘Të drejtat e të moshuarve’**, Departamenti i çështjeve Ekonomike dhe Sociale, divizioni për Zhvillime Sociale dhe Politike, Programi i Moshimit, Bon, Gjermani, 5–7 Maj 2009: [www.un.org/esa/socdev/ageing/documents/egm/bonn09/report.pdf](http://www.un.org/esa/socdev/ageing/documents/egm/bonn09/report.pdf)

**Takimi i Asamblesë së Dytë Botërore mbi moshimin: Raport i Sekretarit të Përgjithshëm**, KB, Asambleja e Përgjithshme, Sesioni i 64-të, A/64/127, 6 Qershor 2009:

[www.globalaging.org/agingwatch/GA/SGr eport64.pdf](http://www.globalaging.org/agingwatch/GA/SGr eport64.pdf)

Fokusi kryesor në raport është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut që lidhen me të moshuarit në kontekstin e zbatimit të instrumenteve ligjorë dhe politik, sikurse dhe veprimet kombëtare. Përmban rekomanimet për një Konventë të re të KB mbi të Drejtat e të Moshuarve.

**Deklarata e Torontos për Parandalimin Global të Abuzimit të të Moshuarve**, OBSH, 2002:

[www.who.int/ageing/projects/elder\\_abuse/alc\\_toronto\\_declaration\\_en.pdf](http://www.who.int/ageing/projects/elder_abuse/alc_toronto_declaration_en.pdf)

Kjo deklaratë është një thirrje për veprim me synim parandalimin e abuzimit me të moshuarit.

#### **Analizë e ligjeve ndërkombëtare aktuale**

**Të drejtat e të Moshuarve: Ligj Ndërkombëtar, Mekanizma të të Drejtave të Njeriut dhe Momenti për një Normativë të Re,** Lindsay Judge, Simpoziumi Ndërkombëtar për të Drejtat e të Moshuarve, Londër, Janar, 2009.

**Karta për Avdokaci e Qendrës Ndërkombëtare Longevity mbi të Drejtat e të Moshuarve,** përgatitur nga studio ligjore Schulte Roth & Zabel LLP për Qendrën Ndërkombëtare Longevity, New York, Qershor, 2009.

**Çfarë ndryshimi do të sjellë një konventë e re në jetën e të moshuarve?**

Dr Israel Doron, PhD dhe Mr Itai Apter, LLM, Simpoziumi Ndërkombëtar për të Drejtat e të Moshuarve, Londër, Janar, 2009.

**Draft –Deklarata e KB mbi të Drejtat e të Moshuarve,** përgatitur nga Klinika Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut Allard K. Lowenstein, Shkolla Ligjore Yale me Qendrën Ndërkombëtare Longevity, 3 Qershor 2008.

**Përmbledhje e ligjeve dhe të drejtave në vende të ndryshme**

#### **Përmbledhje e Ligjeve Ndërkombëtare:**

**Vietnam, Brazil, Shtetet e Bashkuara të Amerikës,** përgatitur nga studio ligjore Schulte Roth & Zabel LLP për Qendrën Ndërkombëtare Longevity, Qershor 2009.

**Përmbledhje e Ligjeve Ndërkombëtare: Kina, India, Bashkimi Europian, Spanja, Portugalia, Afrika e Jugut,** përgatitur nga studio ligjore Schulte Roth & Zabel LLP për Qendrën Ndërkombëtare Longevity, Qershor 2009.

**Një raport mbi të Drejtat e Njeriut për të Moshuarit në Amerikën Latine,** Luz Barreto, Simpoziumi Ndërkombëtar për të Drejtat e të Moshuarve, Londër, Janar, 2009.


**Të Drejtat e të Moshuarve – perspektiva Afrikane,** Jody Kollapan, Simpoziumi Ndërkombëtar për të Drejtat e të Moshuarve, Londër, Janar, 2009.

**Të Drejtat e të Moshuarve në SHBA dhe Kanada,** Tom Osborne and Dan Furlong, Simpoziumi Ndërkombëtar për të Drejtat e të Moshuarve, Londër, Janar, 2009.

**Të Drejtat e të Moshuarve në Azi,** Niti Saxena, Simpoziumi Ndërkombëtar për të Drejtat e të Moshuarve, Londër, Janar, 2009.

**Mbrojtja e të Drejtave të të Moshuarve në Evropë: një perspektivë ligjore,** Geraldine Van Bueren, Simpoziumi Ndërkombëtar për të Drejtat e të Moshuarve, Londër, Janar, 2009.

Ky piblikim u realizua në bashkëpunim me organizatat e mëposhtme:



**INPEA**  
[www.inpea.net](http://www.inpea.net)  
[sbsomers5@aol.com](mailto:sbsomers5@aol.com)



**IFA**  
[www.ifa-fiv.org](http://www.ifa-fiv.org)  
[gshaw@ifa-fiv.org](mailto:gshaw@ifa-fiv.org)



**ILC-US**  
[www.ilcusa.org](http://www.ilcusa.org)  
[media@ilcusa.org](mailto:media@ilcusa.org)



**IAGG**  
[www.iagg.info](http://www.iagg.info)  
[seynes@cict.fr](mailto:seynes@cict.fr)



**IAHSA**  
[www.iahsa.net](http://www.iahsa.net)  
[iahsa@aahsa.org](mailto:iahsa@aahsa.org)



**HelpAge International**  
[www.helpage.org](http://www.helpage.org)  
[bsleap@helpage.org](mailto:bsleap@helpage.org)



**GAA**  
[www.globalaging.org](http://www.globalaging.org)  
[globalaging@globalaging.org](mailto:globalaging@globalaging.org)



**Age UK**  
The new force combining  
Age Concern and Help the Aged  
[www.ageuk.org.uk](http://www.ageuk.org.uk)  
[international@ageuk.org.uk](mailto:international@ageuk.org.uk)



**AARP**  
[www.aarpinternational.org](http://www.aarpinternational.org)  
[intlaffairs@aarp.org](mailto:intlaffairs@aarp.org)